

## RELACION

### PËR

#### PROJEKTVENDIMIN “PËR CAKTIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, SI ORGAN QENDROR BLERËS, PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT, ME OBJEKT ‘MBROJTJEN E GËSHTENJËS NGA PARAZITI GRERËZA GALEFORMUESE (*DRYOCOSMUS KURIPHILUS* *HYMENOPTERA CYNIPIDAE*)’ ”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është caktimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) si Autoritet Kontraktor, për prokurimin e fondeve buxhetore, për trajtimin dhe mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese (*Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae*).

Objektivi i projektvendimit është vijimi i trajtimit të kryer në vitet 2020 dhe 2021, i cili arrihet nëpërmjet prokurimit për trajtimin dhe mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza Galeformuese.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë shqiptare për rritjen e prodhimit dhe të eksporteve, që në rastin e gështenjës arrihet duke çrrënjosur, larguar ose kufizuar parazitët.

Projektvendimi nuk është i parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve për vitin 2022, dhe ka karakter teknik.

PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi ka për qëllim të mbrojë fondin pyjor (*gështenjën*) nga dëmtuesit me qëllim luftimin deri në çrrënjosjen e tyre, duke mbajtur në konsideratë që pyjet janë pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese dhe eksportuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit dhe burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik.

Mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit mundëson zhvillimin e bujqësisë, turizmit dhe uljen e varfërisë. Zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në bashkëpunim nga dy ministritë propozuese.

Ndërhyrjet e parashikuara kanë impakt në:

- a. ruajtjen e bimëve nga parazitët e njohur apo ato që nuk janë shfaqur më parë;
- b. kufizimin e përhapjes së parazitit deri në çrrënjosjen e tij në zonën përkatëse;
- c. monitorimin e vazhdueshëm të situatës në një periudhë afatmesme 4-5 vjeçare (viti 2022 është viti i 3-të).

MBZHR ka filluar këtë proces në vitin 2020 në bazë të kërkesave të vazhdueshme nga komuniteti dhe njësitë vendore të cilët kanë kërkuar të merren masat për kufizimin e përhapjes dhe luftimit të këtij paraziti, dhe ka vijuar dhe në vitin 2021. Për vijimin e procesit në vitin 2022 është i nevojshëm caktimi i MBZHR-së për kryerjen e procedurës së prokurimit, lidhjen e kontratës dhe monitorimin. Në këtë mënyrë luftohet paraziti në mënyrë të unifikuar dhe efikase në të gjithë territorin.

Që ndërhyrja të jetë e efektshme për kufizimin e përhapjes së parazitit deri në çrrënjosjen e tij, në zonën përkatëse është e nevojshme që trajtimi për mbrojtjen e gështenjës të kryhet për një periudhë 4-5 vjeçare. Ky projektvendim krijon kushtet e realizimit të procesit për vitin e 3-të.

Në kuadër të organizimit të procedurave të prokurimit, ministria do të bashkëpunojë dhe me njësitë vendore për të mbledhur të dhëna dhe për të marrë informacionin e plotë të zonave të prekura nga paraziti grerëza Galeformuese.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a. Realizimin e procedurës së prokurimit në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimet publike;

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit, me objekt ‘Mbrojtjen e gështenjës nga paraziti grerëza *Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae)*’ ”.

- b. të shpëtojë ankesat e operatorëve ekonomikë dhe të shpalljen e njohurimit të operatorëve të suksesshëm;
- c. Zbatimin dhe monitorimin e plotë të kontratës objekt prokurimi në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- ç. Informimin e bashkive mbi planin e masave si dhe rezultatet e arritura;
- d. Sensibilizimin e banorëve për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikës.

Miratimi i këtij projektvendimi krijon mundësinë që bashkitë të njoftojnë menjëherë ministrinë në lidhje me problematikën e hasura për të mundësuar realizimin e mbrojtjes nga parazitët.

#### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi ka referencë nenin 100 të Kushtetutës; nenin 53 të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”, ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Baza ligjore është në vijim të praktikës së ndjekur në vitin 2021, për miratimin e VKM-së nr. 232, datë 14.4.2021 “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit, me objekt ‘Mbrojtjen e gështenjës nga parazitët grerëza *Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae)*’ ”.

Neni 53, i Ligjit nr. 162/2020, “Blerja e përqëndruar”, parashikon:

*“1. Kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata, nëse marrin një vendim të tillë, mund t’i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve në emër të të tjerëve.*

*2. Këshilli i Ministrave, me kërkesën e një autoriteti ose enti kontraktor ose me nismën e vet mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’i kërkojë organit qendror blerës të kryejë një procedurë të caktuar të përzgjedhjes së fituesit ose një sërë procedurash të tilla në emër të tij, kur blerja e përqëndruar do të ishte më e leverdishme për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregut.*

*Në kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së fituesit, organi qendror blerës zbaton dispozitat e këtij ligji.”*

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit, me objekt ‘Mbrojtjen e gështenjës nga parazitët grerëza *Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae)*’ ”.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk synon përafrim legjislacioni me *acquis* të BE-së.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi, në pikën e parë cakton Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si Autoritet Kontraktor për realizimin e procedurës së prokurimit publik me objekt “Mbrotjen e gështenjës nga paraziti grerëza *Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera: Cynipidae)*”.

Projektvendimi në pikën e dytë përcakton se MBZHR është autoriteti që do të lidhë kontratën, dhe më pas do të monitorojë zbatimin e plotë të saj.

Në pikën e tretë parashikohet se ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore/Bashkitë për monitorimin e respektimit të kërkesave teknike trajtuese të vendosura në zbatim të këtij procesi.

Në pikën e katërt parashikohet se fondet për procedurën e prokurimit publik dhe të cilat financojnë luftimin e grerëzës përballohen nga fondet e MBZHR-së, programi buxhetor “*Siguria Ushqimore dhe Mbrotja e Konsumatorit*”, shpenzime korrente për produktin, sipërfaqe e trajtuar dhe e mbrojtur nga parazitët në fushën e bujqësisë.

Në pikën e pestë parashikohet se ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore/Bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi.

Ky projektvendim dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencinë e Prokurimeve Publike.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për caktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si organ qendror blerës, për realizimin e procedurës së prokurimit, me objekt ‘Mbrotjen e gështenjës nga paraziti grerëza *Galeformuese (Dryocosmus Kuriphilus Hymenoptera Cynipidae)*’ ”.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR  
NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ky projekt-vendim është përgatitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE  
SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO

MINISTËR

FRIDA KRIECA

